

Dardan Berisha, MA¹

UDC:
342.7.037:342.565.4(497.115)

**MBROJTJA E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË
NJERIUT NGA GJYKATA KUSHTETUESE: RASTI I KOSOVËS**

**ЗАШТИТАТА НА ЧОВЕКОВИТЕ СЛОБОДИ И ПРАВА ОД
СТРАНА НА УСТАВНИОТ СУД: СЛУЧАЈОТ КОСОВО**

**PROTECTION OF HUMAN RIGHTS AND FUNDAMENTAL
FREEDOMS BY THE CONSTITUTIONAL COURT: THE CASE
OF KOSOVO**

Abstract

Respecting human rights and fundamental freedoms tend to represent the main dimension of a truly liberal democracy. Recognizing these rights in the constitutional text, embody one of the greatest victories of Western constitutionalism. Following the declaration of independence in 2008, Kosovo adopted its constitution on 9 April 2008, which entered into force on June 15 of that year. In this manner, ranking among the countries with constitutional democracy, giving particular significance to the universal character of human rights, their enforcement and protection in practice. The establishment of the Constitutional Court, on 16 December 2008, concludes an important step forward as regards the construction of a modern constitutional system. However, this article tends to address the concept of human rights; the Kosovo constitutional system regarding the recognition and protection of these

¹ LL.M në të Drejtën Kushtetuese dhe Administrative. Phd. Cand. Në Departamentin Kushtetues në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Asistent në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti". Rruga e Shkronjave Nr.1 20000 Prizren. Republika e Kosovës. (dardanb04@gmail.com).

rights; the role of the constitutional court of Kosovo in the interpretation of human rights - in particular its judicial practice - since its foundation.

Keywords: Kosovo; Human Rights; Constitutional Court; Democracy; Protection; European Convention;

1. Të drejtat dhe liritë e njeriut - kuptimi dhe rëndësia

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet për t'u njohur të drejtat themelore: e drejta për jetën dhe lirinë, të cilat kanë qenë në qendër të përpjekjeve të revolucionit francez. Këtyre të drejtave elementare u shtohen edhe disa të drejta të tjera, siç janë e drejta e barazisë, e drejta e sigurisë dhe e drejta për t'i bërë rezistencë shtypësit.² Ideja e të drejtave të njeriut, bazohet në teorinë e të drejtave natyrore, sipas së cilës para Zotit të gjithë njerëzit janë të barabartë. Nga kjo rrjedh edhe karakteri moral dhe universal i tyre, për faktin se të drejtat e njeriut u takojnë të gjithë njerëzve, në mënyrë të barabartë dhe të patjetërsueshme.³ Kjo ide u pasurua dhe më tej në mësimet e filozofit anglez, Xhon Loku, vepra e të cilit shënon fillimin e kapitullit të shfaqjes së të drejtave të patjetërsueshme të njeriut.⁴ Me fjalë të tjera, njeriu lind i lirë dhe më të drejta të caktuara dhe mbrojtja e tyre është detyra kryesore e shtetit, që nuk mund as t'i heqë e as t'i shkelë ato.⁵ Pa dyshim, kjo sot përbën përkushtimin më të madh të demokracive liberale, që e vendosin në qendër të sistemin politik dinjitetin e njeriut dhe përcaktimin e këtyre të drejtave në tekstet kushtetuese.⁶

Karakteri i të drejtave të njeriut mund të përcaktohet në disa dimensione. Së pari, aspekti vertikal i tyre, që nënkupton kufizimin e pushtetit politik, si kryefjala kryesore e këtyre të drejtave. Së dyti, natyra pozitive të tyre, që d.m.th. se njerëzit i gëzojnë të drejtat, thjesht se janë qenie njerëzore, dhe përjetimi i tyre nuk varet nga përmendja e tyre në tekstin kushtetues. Pra, kushtetuta nuk ka karakter konstituiv të

² Zejnullah Gruda, "E drejta ndërkombëtare publike", Prishtinë 2009, f. 417.

³ Richard A. Primus, "The American Language Of Rights", Cambridge 2004, f. 158-193.

⁴ Zenun Halili, "Politika dhe qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës", Prishtinë 2006, f. 219.

⁵ Luan Omari, Aurela Anastasi, "E drejta kushtetuese", Tiranë 2010, f. 87-91.

⁶ Michael J. Perry, "Constitutional Rights, Moral Controversy, and the Supreme Court", Emory University 2009, f. 23-25.

të drejtave, nuk i krijon ato, por vetëm e njeh ekzistencën e tyre.⁷ Së treti, natyra pozitiviste e të drejtave të njeriut, që nënkupton se individët i gëzojnë këto të drejta vetëm nga fakti se si të tilla përcaktohen nga teksti kushtetues.⁸ Praktika e deklaramit të të drejtave të njeriut në tekstet kushtetuese fillon me vet konstitucionalizmin dhe me konceptin e supremacisë së kushtetutës. Që në kushtetutat e para hasen dispozitat mbi të drejtat njerëzore dhe liritë themelore.⁹ Kushtetuta amerikane (1789), ajo e Francës (1791) dhe e Vajmarit (1919), përmbanin të drejtat dhe liritë themelore në tekstin e tyre kushtetues. Kjo formë e rregullimit dhe e garantimit kushtetues të lirive dhe të drejtave të njeriut praktikohet edhe në kushtetutat e vendeve të shumta të miratuara pas Luftës së Dytë Botërore.¹⁰ Kushtetuta italiane (1948) dhe kushtetuta gjermane (1949) janë dy shembuj në këtë drejtim. Si rregull, të gjitha vendet pas luftës së dytë kishin vendosur në tekstin e tyre kushtetues dispozita mbi të drejta dhe liritë themelore. Një gjë e tillë vazhdoi edhe me kushtetutat e Portugalisë (1982) dhe Spanjës (1978). Realiteti sot është që nuk gjendet asnjë vend pa një përmbajtje të tillë, duke i përfshirë edhe të gjitha vendet ish-socialiste.¹¹

Përpjekja për të mbrojtur të drejta dhe liritë e njeriut në nivelin ndërkombëtar fillon me themelimin e Kombeve të Bashkuara, atëherë kur komuniteti ndërkombëtar mbrojtjen e drejtave të njeriut e shihte si elementin kryesor të paqes dhe bashkëpunimit. Në vitin 1948 u miratua Deklarata universale e të drejtave të njeriut,¹² e ndjekur nga dy konventa tjera ndërkombëtare të vitit 1966: Konventa për të drejtat politike dhe civile dhe ajo për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Inspiruar nga këto konventa, filluan të miratohen edhe shumë të tjera me karakter

⁷ Allan R. Brewer Carias, "Constitutional Protection Of Human Rights in Latin America - A Comparative Study Of Amparo Proceedings", Cambridge 2009, f. 29.

⁸ Enver Hasani, "Veçoritë themelore të sistemit kushtetues në Kosovë", Revista e Drejta, Nr. 1-4 2014, f. 22-23.

⁹ Enver Hasani, Ivan Cukalovic, "Komentari i Kushtetutës së Kosovës", Prishtinë 2013, f. 76.

¹⁰ Kurtesh Salihu, "E drejta kushtetuese", Prishtinë 2004, f. 208.

¹¹ Levent Gonenc, "Prospects For Constitutionalism In Post-Communist Countries", Ankara University, Turkey 2012, f. 215.

¹² "Deklarata universale e të drejtave të njeriut", më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli Deklaratën universale për të drejtat e njeriut. Pas këtij akti historik, Asambleja ftoi të gjitha shtetet anëtare që ta shpallin tekstin e Deklaratës dhe të përpiqen që të përhapet, të paraqitet, të lexohet dhe të shpjegohet sidomos në shkolla dhe institucione të tjera edukative të të gjitha vendeve dhe shteteve pa marrë parasysh statusin e tyre politik.

rajonat, si për shembull, Konventa evropiane për të drejtat e njeriut (1950), Konventa amerikane për të drejtat e njeriut (1969) dhe ajo afrikane (1987).¹³

2. Të drejtat dhe liritë themelore në Kushtetutën e Kosovës

Kushtetuta e Kosovës ka ndërtuar sistemin e vet të konstitucionalizmit, në frymën e plotë të demokracive liberale perëndimore, e që bazohet së paku në tre dimensione kryesore:

- Së pari, zgjedhje demokratike për legjislativin;
- Së dyti, garanci për të drejtat individuale;
- Së treti, gjyqësorë të pavarur me autoritetin për të mbrojtur standardet kushtetuese, përfshirë të drejtat dhe liritë themelore.¹⁴

Kushtetuta e Kosovës përmban dhe garanton një varg të të drejtave dhe lirive të njeriut, ato mund të ndahen në disa grupe, përkatësisht në: të drejta dhe liri personale; të drejta dhe liri civile dhe politike; të drejta dhe liri sociale, ekonomike dhe kulturore.¹⁵ Këtu fjala është për dispozita kushtetuese të cilat gjenden në nenet 21-62 të Kapitullit II [“Të drejtat dhe liritë themelore”] dhe të Kapitullit III [“Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”] të Kushtetutës.¹⁶

Kushtetuta, në Kapitullin II, përmban dispozita që kryesisht reflektojnë natyrën natyrore të të drejtave të njeriut, ndërkohë që Kapitulli III ngërthen të kundërtën e saj, pra natyrën pozitiviste të të drejtave të njeriut. Natyra pozitiviste vërehet në këtë kapitull, nisur nga fakti se reflekton kontestin kosovar në tërësi, dhe vështirë se mund të gjendet gjetiu në Evropë nëpër tekstet kushtetuese.¹⁷ Për dimensionin natyror flet dispozita e nenit 21.1 [“Parimet e përgjithshme”] të Kapitullit II të Kushtetutës, i cili thotë, si vijon: “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës”.¹⁸ Dimensioi tjetër, ai pozitivist, pasqyrohet në dispozitat e Kapitullit III. Ky kapitull

¹³ Hilaire Barnett, “Constitutional And Administrative Law”, University of London 2002, f. 594.

¹⁴ Sujit Choudhry, “The Migration Of Constitutional Ideas”, Cambridge 2006, f. 116.

¹⁵ Arsim Bajrami, “Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës”, Prishtinë 2014, f. 188.

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II (Të drejtat dhe liritë themelore) dhe Kapitulli III (Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre).

¹⁷ Enver Hasani, “Veçoritë themelore të sistemit kushtetues në Kosovë”, Revista e Drejta, Nr. 1-4 2014, f. 22-23.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II, Neni 21.1 (Parimet e përgjithshme)

është efekt reflektiv i kontekstit specifik kosovar lidhur me mbrojtjen dhe me përparimin e të drejtave dhe lirive njerëzore të grupeve të caktuara, të cilësuar si komunitete, të cilat janë pjesë përbërëse e popullsisë së Kosovës. Në parimin e parë të nenit 57 [“Parimet e përgjithshme”] të Kapitullit III të Kushtetutës përcaktohet, se këto të drejta i gëzojnë “Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (komunitetet) krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute”.¹⁹

Kapitulli II i Kushtetutës paraqet edhe dimensionin individual të të drejtave të njeriut, në kuptimin që përcaktohen të drejtat individuale për secilin qytetar të tilla si: e drejta për jetë; barazia para ligjit; dinjiteti i njeriut; e drejta e privatësisë; e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm; liria e lëvizjes; dhe të tjera.²⁰ Ndërsa kapitulli III i Kushtetutës përbën grupin e të drejtave kolektive, të cilat i njihen vetëm pjesëtarëve të komuniteteve, të tilla si përfaqësimi i tyre në parlament dhe në administratën publike, përdorimi i gjuhëve amtare, ruajtja e identitetit, dhe të tjera. Këto të drejta sigurojnë një autonomi të lartë kulturore, në veçanti për komunitetin serb, si lejimi i përdorimit të gjuhës, statusi special i monumenteve kulturore dhe fetare, e drejta për shkollim në gjuhën e tyre, përfaqësimi i identitetit të tyre në simbolet shtetërore, e të tjera.²¹

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban edhe një numër të caktuar të instrumenteve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare], përcakton se “të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, garantoohen me këtë kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike”.²² Instrumentet ndërkombëtare të përfshira në kushtetutë janë: Deklarata universale për të drejtat e

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitull III, Neni 57.1 (Parimet e përgjithshme)

²⁰ Paul de Hert Fisnik Korenica, “The New Kosovo Constitution and Its Relationship with the European Convention on Human Rights: Constitutionalization “Without” Ratification in Post-Conflict Societies”, *ZaöRV* 76 (2016), f. 147.

²¹ F. Korenica/D. Doli, “The Politics of Constitutional Design in Divided Societies: The Case of Kosovo”, *Croatian Yearbook of European Law and Policy*, f. 285.

²² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare].

njeriut; Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokollet e saj; Konventa ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë civile e politike dhe protokollet e saj; Konventa kor-nizë e këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare; Kon-venta për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor; Kon-venta për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas; Konventa për të drejtat e fëmijës; Konventa kundër torturës dhe trajti-meve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.²³

3. Gjykata Kushtetuese dhe të drejtat e njeriut

Deklarimi kushtetues i të drejtave të njeriut në kushtetutë ose në akte ndërkombëtare, do të ishte i kotë nëse këto të drejta nuk mbrohen nga disa mekanizma kushtetues. Të drejtat e njeriut, mbrojtja dhe garantimi i tyre, mund të bëhet vetëm me anë të një sistemi të pavarur gjyqësor. Kjo mund të arrihet me anë të rregullimit të përgjithshëm të procedurave ligjore që u mundësojnë individëve mbrojtjen e këtyre të drejta.²⁴

Anglia ishte vendi ku liritë publike ishin mbrojtur më herët se kudo kundër arbitraritetit të qeverisë. Ishin gjykatat, me vendimet e tyre në çështjet e zakonshme, që formuluan parimet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.²⁵ Të njëjtin rol historikisht e ka luajtur edhe Gjykata Supreme në Amerikë me interpretimin që ua kishte bërë këtyre të drejtave, duke i zgjeruar në masë të madhe ato. Në periudhën që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, demokracitë më liberale ndoqën shembullin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fuqizimin e gjykatave të tyre në mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të njeriut.²⁶ Në Francë, Kush-tetuta e 1958 nuk i jepte fuqi Këshillit kushtetues francez për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por në një numër të madh të vendimeve në vitin 1970, këshilli ia dha këtë pushtet vetes. Gjykata e Lartë e Izraelit në vitin 1990, ndryshoi rrënjësisht kushtetutën kombëtare duke inkorpo-ruar dy ligje bazike në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në

²³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22.1 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare].

²⁴ Allan R. Brewer Carias, "Constitutional Protection Of Human Rights in Latin Ame-rica - A Comparative Study Of Amparo Proceedings", Cambridge 2009, f. 80-82.

²⁵ Luan Omari, "Shteti i së Drejtës", Tiranë 2012, f. 285-290.

²⁶ Michael J. Perry, "Toward a Theory of Human Rights Religion, Law, Courts", Emory University 2007, f. 88.

Indi, Gjykata e Lartë për disa dekada ka zgjeruar në mënyrë drastike fushëveprimin e shumë të drejtave.²⁷

Trendi i përgjithshëm i mbrojtjes së të drejtave kushtetuese në Evropë është i rregulluar sipas modelit të Hans Kelsenit, i bazuar në gjykata ose tribunale të veçanta kushtetuese.²⁸ Arsyetimi kryesor për ekzistencën e këtyre gjykatave, sidomos në vendet ish-komuniste, bazohet në rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ideja është që gjykatat kushtetuese duhet të kenë një fuqi shumë të madhe në shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, sa herë që të drejtat e njeriut janë në pyetje.²⁹ Procedura për mbrojtjen e këtyre të drejtave realizohet nëpërmjet ankesës kushtetuese, e cila u mundëson individëve dhe grupeve të caktuara, të parashirojnë ankesë pranë gjykatës kushtetuese kur pretendojnë që të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur nga autoritetet publike.³⁰

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton në mënyrë të qartë parimin e mbrojtjes së të drejtave në mënyrë gjyqësore. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.³¹

Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton që individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.³² Në përgjithësi, neni 113.7 përbën hapësirën e vetme ku kushtetuta i autorizon individët që të inicojnë procedurë të kontrollit kushtetues para Gjykatës kushtetuese, përderisa sipas këtij juridiksioni, Gjykata ushtron kontroll të tipit konkret/individual. Kjo përbën kanalën e vetëm juridik ku Gjykata kontrollon kushtetutshmërinë e akteve

²⁷ Sujit Choudhry, "The Migration Of Constitutional Ideas", Cambridge 2006, f. 117.

²⁸ Allan R. Brewer – Carias, "Constitutional Protection of Human Rights in Latin America - A Comparative Study of Amparo Proceedings", Cambridge 2009, f. 89.

²⁹ Wojciech Sadurski, "Rights Before Courts A Study of Constitutional Courts in Postcommunist States of Central and Eastern Europe", Springer 2008, f. 107.

³⁰ Sweet, Alec Stone, "Constitutional Courts" (2012). Faculty Scholarship Series. Paper 4627, f. 823.

³¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 54 (Mbrojtja gjyqësore e të drejtave)

³² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 113.7 (Juridiksioni dhe palët e autorizuara).

individuale të autoriteteve publike, në kuptim të përputhshmërisë së tyre me të drejtat individuale të përcaktuara me kushtetutë.³³

Në kuptim të këtij juridiksioni, sipas nenit 113.7, çështja e parë që shtrohet është subjekti i autorizuar për të ngritur para Gjykatës këtë kontroll kushtetues. Ky paragraf përcakton që “individët” janë e vetmja palë e autorizuar për ta ngritur këtë kontroll. Koncepti “individ” përfshin personat fizik, por dhe ata juridik, për aq sa është e mundur që personat juridik t’i gëzojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me kushtetutë.³⁴ Çështja e dytë në kuptim të këtij juridiksioni ka të bëjë me shterimin e mjeteve juridike. Neni 113.7 përcakton që individët mund të ngrenë çështjen vetëm pasi t’i kenë shterë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Përpara se një çështje të mund të ngrihet në Gjykatën Kushtetuese, duhet lejuar që së pari gjykatat e rregullta por dhe institucionet shtetërore në përgjithësi, ta korrektojnë shkeljen e supozuar. Nëse ky sistem nuk funksionon, atëherë hyn në funksion juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese si gjykatë subsidiare. Në këtë kuptim, gjatë vlerësimit të shterjes së mjeteve juridike, Gjykata duhet vlerësuar jo thjeshtë aspektin formal të sistemit të mjeteve juridike, por dhe rrethanat e përgjithshme, sistemin juridik dhe politik në të cilin ka pasur akses parashtruesi, si dhe kontekstin personal të tij.³⁵

Kusht tjetër që individi të parashtrorë kërkesë në Gjykatë është që ai të jetë viktimë e drejtpërdrejtë e ndonjë shkelje kushtetuese nga një autoritet publik.

Në rastin Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës,³⁶ Gjykata e pranoi kërkesën sepse që të dytë ishin prindërit e së ndjerës Diana Kastrati e cila ishte subjekt i shkeljes së të drejtave të njeriut. Në këtë rast ata ishin viktima indirekte të shkeljes së të drejtave të njeriut.

E rëndësishme është që të sqarohet dhe koncepti “shkelje” e autoritetit publik ndaj një personi. Duhet thënë që, në parim, në mënyrë që shkelja e një të drejte apo lirie kushtetuese të ndodh, duhet që të ketë një veprim të një organi publik. Gjykata në rastin Valon Bislimi kundër

³³ Enver Hasani, Ivan Cukalovic, “Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës”, Prishtinë 2013, f. 590.

³⁴ Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rasi Nr. KL. 41/09. Aktvendim për Papranueshmëri. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, datë: 27 janar 2010 (Ref.: Nr. RK-04/10).

³⁵ Enver Hasani, Ivan Cukalovic, “Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës”, Prishtinë 2013, f. 592.

Ministrisë së Punëve të Brendshme,³⁷ ka vendosur parimin që shkelja kushtetuese mund të ndodhë dhe nga heqja dorë ose abstenimi i autoriteteve publike për të ndërmarrë një veprim i cili si pasojë sjell shkelje të të drejtave dhe lirive themelore. Pra në kuptim të nenin 113.7, veprimi dhe mosveprimi i një autoriteti publik mund të jenë shkaqe mbi të cilat kryhet shkelja kushtetuese.

Çështja e fundit që duhet trajtohet në kuptim të këtij juridiksioni është që, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka vendosur parimin që qytetarët mund të ankohen ndaj një akti të përgjithshëm juridik të administratës, me kusht që ai të ketë qenë viktimë e shkeljes së ndonjë të drejte nga ky akt. Në rastin Krasniqi kundër RTK,³⁸ Gjykata vendos në mënyrë inovative për këtë çështje. Gjykata lejoj një lloj gjysmë - actio - popularis, duke vendosur që megjithatë një parashtrues mund të kontestojë kushtetutshmërinë e një ligji nëse ligji në fjalë është burim direkt i shkeljes së të drejtës së tij/saj kushtetuese.

Në rastin e njohur si “Diana Kastrati”, Gjykata interpretoi të drejtën për jetë. Viktima humbi jetën pasi u vra nga ish-bashkëshorti i saj në qendër të qytetit. Përpara se të vritej, ajo kishte kërkuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë një urdhër mbrojtje, pasi në vazhdimësi kishte marrë mesazhe kërcënuese për jetën e saj. Prindërit e së ndjerës, ishin ankuar në Gjykatë Kushtetuese me pretendimin se Gjykata Komunale e Prishtinës, me mosveprimin e saj në përputhje me obligimet e saj ligjore dhe kushtetuese për ta trajtuar kërkesën për urdhër të mbrojtjes emergjente, ka cenuar të drejtat individuale të së ndjerës, të garantuar me nenin 25 të kushtetutës (E drejta për jetë). Gjykata ishte shprehur se është detyrim i organeve shtetërore që, jo vetëm të përmbahen nga marrje e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por gjithashtu të ndërmarrin hapat e duhur për mbrojtjen e jetës së individëve brenda juridiksionit të tyre. Gjykata gjeti se ka pasur shkelje të së drejtës për jetë të paraparë me nenin 25 të Kushtetutës dhe me nenin 2 te KEDNJ.³⁹

Në rastin “Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë”, Gjykata

³⁷ Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë. Aktgjykim. Rasti KI 06/10. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 30 tetor 2010 (Nr.Ref.:AGJ 63/10).

³⁸ Tomë Krasniqi kundër RTK-së. Vendim për masë të përkohshme. Rasti KI 11/09. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 16 tetor 2009. (Nr. Ref.: MP 01/09).

³⁹ Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Aktgjykim. Rasti KL 41/12. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 26 shkurt 2013 (Nr.Ref.:AGJ 361/13).

interpretoi lirinë e lëvizjes. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se atij i është shkëlur e drejta për t'u larguar nga vendi pasi i ishte refuzuar lëshimi i pasaportës, e cila kërkohet për të udhëtuar. Autoritetet vendase kishin refuzuar lëshimin e pasaportës për shkak se parashtruesi i kërkesës ishte i akuzuar në një procedurë penale. Parashtruesi pretendonte se kufizimi i lirisë së lëvizjes mund të bëhej vetëm në rastet në të cilat gjykata kompetente ka lëshuar vendim paraprak. Gjatë një argumentimi tepër të gjatë, Gjykata Kushtetuese konsideroi që ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për liri të lëvizjes të garantuar me Nenin 35.2 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.⁴⁰

Gjykata Kushtetuese kishte interpretuar në disa raste dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në një rast, Gjykata Kushtetuese rrezoi aktgjykimin e Gjykatës Supreme e cila i vërtetoi aktgjykimet e gjykatave të rregullta. Rasti kishte të bënte me një aktgjykim penal, në të cilën parashtruesi Bajrush Xhemajli ishte dënuar me burgim për shkak të një aksidenti në komunikacion. Nga ky aksident humbi jetën një person. Parashtruesi i ankesës në Gjykatën Kushtetuese kundërshtoi vendimin e Gjykatës Supreme me pretendimin se Gjykata Supreme dhe gjykatat e rregullta nuk e kishin lejuar super-ekspertizën të cilën ai e kishte kërkuar. Gjykata kushtetuese ishte shprehur se të akuzuarit nuk duhet t'i mohohet e drejta për të zgjedhur vetë ekspertizën për të cilën konsideron se është në favor të tij. Gjykata nuk duhet të refuzojë kërkesën e të akuzuarit për të propozuar kryerjen e super-ekspertizës nëse ai/ajo konsideron se një gjë e tillë është në favor të tij/saj.⁴¹

Të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata e kishte mbrojtur dhe në rastin e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit nga ana e Këshillit Prokurorial. Pas përfundimit të procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit, një nga kandidatët për këtë pozitë, Laura Pula, ishte ankuar në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se asaj i ishte shkëlur e drejta për gjykim të drejtë. Ankuesja pretendonte se gjatë procedurës së votimit, kishte marrë pjesë dhe një kandidat tjetër, e që sipas saj përbënte konflikt interesi. Gjykata ishte shprehur se këto rrethana

⁴⁰ Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë. Aktgjykim. Rasti Kl 06/10. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 30 tetor 2010 (Nr.Ref.:AGJ 63/10)

⁴¹ Bajrush Xhemajli kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Aktgjykim. Rasti Kl 78/12. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 24 janar 2013 (Nr.Ref.:PKL 70/2012).

shërbejnë në mënyrë objektive për të arsyetuar frikën e parashtresit se, Këshilli Prokurorial, gjatë procedurave të votimit për kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit, duke përfshirë një anëtar i cili ishte gjithashtu kandidat për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, i kishte munguar shfaqja e paanësisë së nevojshme. Gjykata konsideron se anëtari që ishte kandidat për postin e Kryeprokurorit të Shtetit duhej të ishte përjashtuar nga procedurat e votimit duhej të ishte zëvendësuar me një anëtar tjetër. Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të neni 31 të Kushtetutës (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm).⁴²

Gjykata Kushtetuese, ka dëshmuar të jetë gardian i të drejtave dhe lirive themelore, sa herë që parashtresit kanë arritur të argumentojnë përpara Gjykatës shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë. Kështu, ajo shpeshherë i ka interpretuar këto të drejta në mënyrë mjaft krijuese duke ruajtur dhe pasuruar dhe më tej dispozitat kushtetuese mbi të drejtat e njeriut. Të dhënat e fundit statistikore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës tregojnë për një trend në rritje të kërkesave individuale. Ky është indikator i më i besueshëm për rëndësinë e këtij instrumenti për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese.

4. Raporti midis Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Në përgjigje të tmerreve gjenocidale të Luftës së Dytë Botërore, komuniteti evropian njohu nevojën për një sistem rajonal për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Elitat dhe dijetarët konsideronin se mosrespektimi i ligjit dhe i të drejtave të njeriut është një force destabilizuese rajonale.⁴³ Kongresi i Hagës i drejtuar nga Winston Çurçilli u ndoq nga 800 udhëheqës evropianë dhe delegatë nga 30 vende. Kongresi i mbylli punimet duke rekomanduar tre gjëra: krijimin e një bashkimi ekonomik e politik, mbledhjen e një asambleje për të rrahur mendimet dhe përgatitjen e një karte për të drejtat e njeriut me një gjykatë evropiane të drejtësisë për të siguruar zbatimin e saj.⁴⁴

⁴² Shyqri Sylja dhe Laura Pula kundër vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit. Aktgjykim. Rasti KL 99/14 dhe KL 100/14. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 8 korrik 2014 (Nr.Ref.: AGJ679/4).

⁴³ Francisco Forrest Martin, Stephen J. Schnably, Richard J. Wilson, Jonathan S. Simon, Mark V. Tushnet, "International Human Rights and Humanitarian Law Treaties, Cases And Analysis", Cambridge 2006, f. 16.

⁴⁴ Aline Royer, "Këshilli i Evropës", Milano janar 2010, Shtypur në Këshillin e Evropës, f. 5.

Në vitin 1950, Këshilli i Evropës krijoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila hyri në fuqi në vitin 1953. Konventa konsiderohet gjerësisht si instrumenti ndërkombëtar më efektiv për mbrojtjen e të drejtave individuale. Në përmbajtjen e Konventës vëmë re se në krahasim me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, ajo i kushton më tepër rëndësi mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, se sa thjesht afirmimit të tyre.⁴⁵ Në të vërtetë, qëllimi i Këshillit të Evropës ishte që me këtë Konventë të bëhen hapat e parë për zbatimin e të drejtave të caktuara të vendosura me Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut të vitit 1948. Për ta implementuar konventën në tërësi, u krijua Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, funksioni i së cilës është interpretimi dhe mbrojtja e të drejtave të listuara në Konventë.

Bashkëpunimi i GJEDNJ me gjykatat kushtetuese të vendeve anëtare të këshillit paraqet një nga gjërat më të rëndësishme në implementimin e konventës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.⁴⁶ Në kuptim të bashkëveprimit të Gjykatave kushtetuese me GJEDNJ, është e rëndësishme të theksohet ndikimi i madh i GJEDNJ dhe Konventës në sistemet e brendshme kombëtare. Shembulli më i mirë që pasqyron këtë është interpretimi i së drejtës për jetë apo largimi i dënimit me vdekje në sistemet që kanë aplikuar atë. Kjo dëshmohet edhe në Shqipëri e cila e kishte të paraparë në kodin penal të saj dënimin me vdekje. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë duke analizuar sipas frymës së Kushtetutës dhe Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, konsideroi që dënimi me vdekje është i papajtueshëm me thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive. Ai është një mohim i të drejtës për jetën dhe në vetvete përbën një dënim çnjerëzor e mizor, që shteti e realizon nëpërmjet pushtetit të tij gjyqësor.⁴⁷

Në lidhje me sistemin kushtetues kosovar, duhet përmendur tre gjëra. Së pari, Kosova nuk është pjesë e Konventës dhe në kuptimin ndërkombëtar nuk është e detyruar që ta zbatojë atë. Pavarësisht kësaj, Kushtetuta e Kosovës ka inkorporuar brenda tekstit kushtetues

⁴⁵ Luan Omari, Aurela Anastasi, "E drejta kushtetuese" Tiranë 2010, f. 114.

⁴⁶ "The Protection Of Human Rights Within The European Cooperation Of Courts", European Commission For Democracy Through Law (VENICE COMMISSION) Venice, Italy, 9 March 2013, Prezantim i paraqitur në Komisionin e Venecias nga Andreas Voßkuhle - Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë.

⁴⁷ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendimi nr.65, datë 10.12.1999 (V-65/1999 - Shfuqizimi i dënimit me vdekje).

Konventën evropiane për të drejtat e njeriut dhe protokollet e saj.⁴⁸ Së dyti, është çështja e vendit dhe rëndësisë së Konventës brenda sistemit kushtetues kosovar. Në këtë kuptim, Kushtetuta përcakton se konventa zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe në rast konflikti me dispozitat e tjera ligjore dhe me aktet tjera të institucioneve publike, konventa ka epërsi.⁴⁹ Së treti, është fakti nëse konventa dhe protokollet e saj mund të zbatohen direkt dhe në mënyrë efektive nga ana e gjykatave. Kushtetuta përcakton shumë qartë se të Drejtat dhe Liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁵⁰

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës plotësisht e ka zbatuar këtë detyrim kushtetues. Gjatë të gjitha vendimeve të saj, Gjykata Kushtetuese ka përdorur praktikën e GJEDNJ si udhëzues gjatë vendim-marrjes. Kjo e ka bërë shumë më të lehtë punën e Gjykatës Kushtetuese sidomos gjatë interpretimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.⁵¹

Përgjatë gjithë periudhës së funksionimit, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka nxjerrë më shumë se 12.000 vendime. Forca detyruese e këtyre vendimeve ka obliguar shtetet të bëjnë ndryshime në strukturën ligjore dhe në praktikat administrative. Përmes praktikës së gjykatës, konventa evropiane është bërë një instrument shumë i fuqishëm në promovimin e sundimit të ligjit dhe demokracisë kudo në Evropë.⁵² Vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë respektuar pothuajse universalisht nga të gjitha shtetet që e kanë ratifikuar Konventën. Në të njëjtën linjë kanë qenë edhe të gjitha vendet ish-komuniste, të cilat kanë shprehur qëndrimin në favor të integritimit evropian dhe asnjëra prej tyre nuk e ka refuzuar supremacinë e ligjeve të BE mbi të drejtën kombëtare.⁵³

⁴⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve Ndërkombëtare).

⁴⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve Ndërkombëtare).

⁵⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 53 (Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut).

⁵¹ Enver Hasani, "The effect and impact of international treaties/conventions on human rights into national constitutional system: the case of Kosovo", International Constitutional Law, Torino 2014.

⁵² 50 Years of Activity, The European Court of Human rights, some facts and figures, council of Europe, provisional edition (April 2010).

⁵³ Darinka Piqani, "Constitutional Court in Central and East Europe and their Attitude towards European Integrations". f. 20.

Conclusion

The human rights catalogue embodied in the constitutional text, and the incorporation of international instruments in the field of human rights and freedoms, however, represents only one side of the same coin. Enforcing and protecting these rights in practice poses a challenge in itself, putting the whole state apparatus into testing. In all the former socialist countries, part of which was Kosovo too, the foundation of a specialized court—with pure constitutional jurisdiction in the protection and interpretation of these rights—has created novelties and ambiguities among citizens and public institutions as regards the manner of functioning as well as lodging of complaints. This is, however, confirmed through the practice so far, when over 90 percent of human rights and freedoms cases alleging violation, have been declared inadmissible. On the other hand, the constitutional court has shown sufficient activism in the interpretation of human rights and freedoms, in cases when the citizens could persuasively argue the breaches of such rights and freedoms.

On the other hand, state bodies within the Republic of Kosovo have shown willingness to respect court decisions, and to act in accordance with its findings.

Recensentë:**Prof. dr. Muharrem Faiku****Prof. ass. Arif Ritza****Burimet e Konsultuara****Libra:**

Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike”, Prishtinë 2009

Richard A. Primus, “The American Language Of Rights”, Cambridge 2004

Zenun Halili, “Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, Prishtinë 2006

Luan Omari, Aurela Anastasi, “E Drejta Kushtetuese”, Tiranë 2010

Michael J. Perry, “Constitutional Rights, Moral Controversy, and the Supreme Court” Emory University 2009

Allan R. Brewer Carias, “Constitutional Protection Of Human Rights in Latin America - A Comparative Study Of Amparo Proceedings”, Cambridge 2009

Levent Gonenc, "Prospects For Constitutionalism In Post-Communist Countries", Ankara University, Turkey 2012

Hilaire Barnett, "Constitutional And Administrative Law", University of London 2002

Sujit Choudhry, "The Migration Of Constitutional Ideas", Cambridge 2006

Luan Omari, "Shteti i së Drejtës", Tiranë 2012

Wojciech Sadurski, "Rights Before Courts A Study of Constitutional Courts in Postcommunist States of Central and Eastern Europe", Springer 2008

Francisco Forrest Martin, Stephen J. Schnably, Richard J. Wilson, Jonathan S. Simon, Mark V. Tushnet, "International Human Rights and Humanitarian Law TREATIES, CASES AND ANALYSIS", Cambridge 2006

Enver Hasani, Ivan Cukalovic, "Komentar i Kushtetës së Kosovës", Prishtinë 2013

Punime shkencore dhe analiza:

Enver Hasani, "Veçoritë themelore të sistemit kushtetues në Kosovë", Revista e Drejta, Nr 1- 4, 2014

Paul de Hert Fisnik Korenica, "The New Kosovo Constitution and Its Relationship with the European Convention on Human Rights: Constitutionalization "Without" Ratification in Post-Conflict Societies", ZaöRV 76 (2016)

F. Korenica/D. Doli, "The Politics of Constitutional Design in Divided Societies: The Case of Kosovo", Croatian Yearbook of European Law and Policy,

Sweet, Alec Stone, "Constitutional Courts" (2012). Faculty Scholarship Series.Paper 4627

The Protection Of Human Rights Within The European Cooperation Of Courts", European Commission For Democracy Through Law (VENICE COMMISSION) Venice, Italy, 9 March 2013, Prezantim I paraqitur në Komisionin e Venecias nga Andreas Voßkuhle - Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë.

Aline Royer, "Këshilli i Evropës", Milano janar 2010, Shtypur në Këshillin e Evropës

Enver Hasani, "The effect and impact of international treaties/conventions on human rights into national constitutional system: the case of Kosovo", International Consitutional Law, Torino 2014

Darinka Piqani, "Constitutional Court in Central and East Europe and their Attitude towards European Integrations".

"50 Years of Activity, The European Court of Human rights, some facts and figures, council of Europe", provisional edition (April 2010).

Vendime Gjyqësore dhe akte juridike:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 9 prill 2008

Deklara Universale për të Drejtat e Njeriut, 10 dhjetor 1948

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 3 shtator 1953

Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rasi Nr. KL. 41/09. Aktvendim për Papranueshmëri. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Prishtinë, datë: 27 janar 2010 (Ref.: Nr. RK-04/10).

Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësorë dhe Ministrisë së Drejtësisë. Aktgjykim. Rasti KI 06/10. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 30 tetor 2010 (Nr.Ref.:AGJ 63/10).

Tomë Krasniqi kundër RTK – së. Vendim për masë të përkohshme. Rasti KI 11/09. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 16 tetor 2009. (Nr. Ref.: MP 01/09).

Bajrush Xhemajli kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Aktgjykim. Rasti KI 78/12. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 24 janar 2013 (Nr.Ref.: PKL 70/2012).

Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësorë të Kosovës. Aktgjykim. Rasti KL 41/12. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 26 shkurt 2013 (Nr.Ref.:AGJ 361/13).

Shyqri Syla dhe Laura Pula kundër vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit. Aktgjykim. Rasti KL 99/14 dhe KL 100/14. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 8 korrik 2014 (Nr.Ref.: AGJ679/4).

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendimi nr.65, datë 10.12.1999 (V-65/1999 - Shfuqizimi i dënimit me vdekje).